



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

**nga procesverbali i mbajtur më 18 janar 2012, në mbledhjen e XIX
(nëntëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq, z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Liman Zeqiri, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Ylber Salihu, Zyrtar për Integritet Evropian, z. Rafet Dervisholli, Stacioni i policisë Podujevë, z. Habil Sylejmani, Policia kufitare Veriu, z. Bekim Karagjija, OSBE .

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 6 dhjetor 2011

Ekstrakti procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Ngritja e grupit për hartimin e Raportit të punës për vitin 2011 dhe Programin e punës për vitin 2012

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën e hyrjes.

Në vazhdim, pas propozimeve të bëra dhe votimit u konstatua se grupi për hartimin e dokumenteve të cekura, njëzëri, u ngritë në këtë përbërje:

z. Burhan Blakçori, kryetar

z. Nebih Behluli, anëtar

z. Jahë Lahu, anëtar

4. Të ndryshme

z. Jahë Lahu, njoftoi se OJQ “Balkan Sunflowers” përmes avokueses z. Mimoza Stublla do të mbështet implementimin e Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian dhe es mediator i asrimit është caktuar z. Xhafer Ademi.

Mbledhja përfundoi në orën 12.15’.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

**Nr. 01/02-06
Podujevë,
18 janar 2012**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**